



VENDIM

Nr. 32 Date 13.10.2014

PER SHPALLJEN E EKOSISTEMIT NATYROR NIKAJ-MERTUR "PARK NATYROR RAJONAL"

Keshilli i Qarkut Kukës ne mbledhjen e tij te dates se mesiperme, pas shqyrtimit te Relacionit te paraqitur nga AZHR-ja, bazuar ne ligjin Nr.8652 date 31.07.2000 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore,, nenet 7/2, 8/1/b,13, 54, ligjin Nr.8485 date 12.05.1999 "Kodi i Proçedurave Administrative te Republikes se Shqiperise", ligjin Nr. 9868, datë 04.02.2008 "Për zonat e mbrojtura", (i ndryshuar) neni 11/1, VKM Nr.519, date 30.06.2010 "Për proçedurat e propozimit e të miratimit dhe rregullat e administrimit të parqeve natyrore rajonale" pika 4, ne propozimin e bere nga Komuna Lekbibaj si dhe vendimin e Kryesise se Keshillit te Qarkut Kukës, Nr.20, date 13.10.2014 "Per miratimin e P/Akteve per mbledhjen e Keshillit te Qarkut Kukës".

VENDOSI:

1. Shpalljen e ekosistemit natyror Nikaj-Mertur "Park Natyror Rajonal", sipas hartës që i bashkalidhet këtij vendimi.
2. Emertimi i ketij parku do te jete: "**Parku Natyror Rajonal Nikaj-Mertur**".
3. Kufijtë e këtij parku natyror rajonal janë, si më poshtë vijon:
 - a) **Kufiri verior:** Kufizohet me Parkun e Alpeve Shqiptare dhe fillon ne; Majen e Boshit, Maja Suka e Zhapores, Maja e Zhapores, Maja e Brijasit, Maja e Gavnit, Qafa e Drockes, Maja e Alshines.
 - b) **Kufiri lindor:** Maja e Dhive, Maja e Shtylles, Maja e Mekines, Qafa e Kolcit, Maja e Merturit, dhe zbret per kurrizit të malit ne drejtim te Liqenit te Komanit.
 - c) **Kufiri jugor:** Si kufi natyral eshte liqeni i Komanit.
 - d) **Kufiri perëndimor:** Nis me kufizimin me komunen e Shales (Malesi e Madhe) dhe fillon ne; liqenin e Komanit, ngjitet per kurrizi ne kuoten 1180 m ne perendim te fshatit Brisë, vazhdon drejt kuotes 1424 m, Qafa e Agrit, Maja e Agrit (1607 m), Maja e Ershelit, Maja e Shtrezes, Maja e Brodes, Maja e Kakise, Qafa e Kakise, Maja e Boshit.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I QARKUT KUKES



4. Parkut Natyror Rajonal “Nikaj-Mërtur” ka një sipërfaqe të përgjithshme prej **17,505 ha**, ku pjesën kryesore të territorit e zënë sipërfaqet me pyje. Sipërfaqja e përdorimit të territorit të parkut natyror rajonal jepet në tabelën e mëposhtme:

a. **Tabela 1:** Përdorimi i territorit të Parkut;

Nr.	Përdorimi i territorit	Sipërfaqja (ha)
1.	Sipërfaqe e çveshur dhe shkembore	3,863.5
2.	Qendra të banuara, toke bujqesore etj	1,013.4
3.	Sipërfaqe me kullota, livadhe etj	949.4
4.	Sipërfaqe me Rrobull (Pinus heldreichii)	461.2
5.	Sipërfaqe me pshte të zeze (Pinus nigra)	99.0
6.	Sipërfaqe me dushqe, geshtenje, lajthi etj	3,965.6
7.	Pyje me ah etj.	7,152.9
	SIPERFAQE E PERGJITHSHME	17,505

5. Parkut Natyror Rajonal “Nikaj-Mërtur” ndahet në nën-zona ruajtjeje e administrimi, si më poshtë vijon:

5.1. *Zona Qendrore:*

Zona qendrore, me sipërfaqe **1105.6 ha**, e shënuar në hartë me ngjyrë të gjelbër. Përcaktohet si zonë me vlera të larta për trashëgiminë natyrore e biodiversitetin lokal, siguron një territor të pa-shqetësuar dhe zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes.

5.2. *Zona e Përdorimit Tradicional:*

Zona e përdorimit tradicional, me sipërfaqe **11,720.8 ha**, e shënuar në hartë me ngjyrë kafe në të verdhë. Përfshin tërësisht pjesë dushkajave dhe liqenit, ku mundësohet vazhdimi i veprimtarive tradicionale si bujqësi, peshkim, pyje, grumbullimi i bimëve mjekësore dhe i prodhimeve të dyta pyjore, me përdorim të balancuar të tyre, pasi të pajisen me leje përkatëse dhe zbatohet shkalla e dytë e mbrojtjes.

5.3. *Zona e Zhvillimit të Qëndrueshëm:*

Zona e zhvillimit të qëndrueshëm, me sipërfaqe **4,678.6 ha**, e shënuar në hartë me ngjyrë gri. Në këtë zonë lejohen veprimtari të cilat nuk cenojnë integritetin ekologjik të ekosistemit natyror dhe ushtrohen vetëm me leje që nuk bien ndesh me planin e menaxhimit dhe zbatohet shkalla e tretë e mbrojtjes.

b. **Tabela 1:** Sipërfaqja e zonave përbërëse të Parkut Natyror Rajonal “Nikaj-Mërtur”;



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I QARKUT KUKES**



1	Zona qëndrore	1105.6
2	Zona e përdorimit tradicional	11,720.8
3	Zona e zhvillimit të qëndrueshëm	4,678.6
	Totali	17,505

6. Plani i menaxhimit të Parkut Natyror Rajonal "Nikaj-Mërtur", sipas dispozitave në fuqi do të miratohet nga Ministri i Mjedisit.

7. Këshilli i Qarkut, me propozim të Këshillit të Komunes Lekbibaj, miraton rregulloren e ruajtjes, administrimit dhe funksionimit të Parkut Natyror Rajonal "Nikaj-Mërtur".

8. Kryetari i Komunes Lekbibaj, pas miratimit nga Këshilli i Qarkut Kukës për shpalljen e "Parkut Natyror Rajonal Nikaj-Mërtur":

- krijon administratën e parkut, duke përcaktuar strukturën dhe organiken e punonjësve, të cilët përgjigjen për ruajtjen dhe menaxhimin e tij, në bashkëpunim me organet e shërbimit pyjor dhe organet e tjera shtetërore e vendore;
- ndan detyrat me strukturat ekzistuese shtetërore (pyjore, bujqësisë, projekte, etj) brenda zonës për ruajtjen e vlerave natyrore që janë identifikuar;
- kërkon nga organet e specializuara dhe donatorët trajnimin e stafit për ngritjen e kapaciteteve njerëzore të administratës;
- punon për zbatimin e planit të menaxhimit të parkut.


9. Drejtoria TIPS të bëjë publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit, si dhe në mjediset e njoftimeve publike të institucionit.

10. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen, Sekretari i Këshillit të Qarkut Kukës, Agjensia e Zhvillimit Rajonal, Drejtoria TIPS, si dhe Komuna Lekbibaj.

11. Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

KRYETARI

Ibsen ELEZI



Konc: I.Shahu

Ligjshmeria: G.Çejku

Sekretari: B.Ngjeçi

U hartua në 5 (pese) kopje origjinale:

- Zyres së Arkivit
- Institucionit të Prefektit të Qarkut Kukës
- Agjensisë së Zhvillimit Rajonal
- Komunës Lekbibaj